

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC**/Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, në çështjen penale kundër të akuzuarit N. C. nga Rahoveci, rr. "M. M.", nr. ..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.733/2017 të datës 20.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurori i Shtetit Enis Gashi, dhe të akuzuarit, me datë 10.12.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari,

**N. C.**, nga i ati H. dhe e ëma N., e gjinisë B., i lindur me dt. ..., në Rahovec, ku edhe tani jeton, rr. "M. M.", nr. ..., me numër personal ..., punëtor, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i ati i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

### ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Nga data e pavërtetuar e gjerë me dt. 27.05.2016, në shtëpinë e tij, e cila gjendet në Rahovec, rr. "M. M.", nr. ..., me qëllim vetës t'i sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që shifrën DGJ-80005503 njehsorit elektrik me nr. 9824048 diskun e ka çliruar duke frenuar diskun, ashtu që disku i njehsorit ka gjurmë të gërvishtjes, veprime këto që kanë pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar, të konstatuar nga punëtorët e autorizuar të Qendrës së Kalibrimit në Prishtinë, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS-Divizioni Gjakovë, i ka shkaktuar dëme në shumë prej 119,32 €.

**Me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par. 1 pika 1.1, 50, 51, 52 , 73 dhe nenit 320 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtit i shqipton:

### DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin N. C. e gjykon me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve, të cilat dënime nuk do të

ekzekutohen, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara KEDS – Distrikti në Gjakovë, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP.nr.733/2017 të datës 20.07.2017, kundër të pandehurit N. C. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.12.2018, ku ka qenë prezent përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Enis Gashi dhe i akuzuari N. C., ndërsa nuk ka qenë prezent përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjakovë, edhe pse gjykata ka prova se i njëjti ka pranuar ftesën me kohë dhe në mënyrë të rregullt.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i cili ka qendruar në tërësi pranë saj. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, si dhe e ka njoftuar lidhje me efektet e pranimit të fajësisë. I akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ndihet fajtor dhe ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur.

Pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë, po ashtu është kërkuar edhe mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pa presion, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë gjenë mbështetje në provat të cilat i përmban aktakuza, nga të cilat formohen të gjitha elementet e veprës penale me të cilat ngarkohet i akuzuari, sikurse janë të përshkruara në dispozitiv të aktakuzës.

Andaj nga të lartcekurat, pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 248 par. 4 të KPRK-së, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës fillestare është deklaruar i fajshëm, në tërësi e ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ka proceduar administrimin e provave.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikur ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat për të cilat i përmban aktakuza e të cilat janë: Shikimi i procesverbalit mbi konstatimin e gjendjes faktike me nr. 83/02, të dt. 02.09.2016; procesverbali i ndërrimit të njehsorit me nr. 0576697, të dt. 27.05.2016; foto-dokumentacioni, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë, gjykata ka ardhur në përfundim se në

veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale me të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, i njëjti është deklaruar i fajshëm, si dhe i vjen keq për rastin që ka ndodhur, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti, andaj të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me kusht, me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt juridiko civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**  
**P.nr.225/2017, me datë 12.10.2018**

**Sekr. juridike,**  
Shemsije Shehu

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Mizahir Shabani

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.